URDHËR
Nr. 378, datë 6.9.2013

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Universitetin Politeknik të Tiranës të programit të studimeve të ciklit të dytë "Master profesional" në "Inxhinieri mekatronike" në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare "Master profesional" në "Inxhinieri mekatronike".

2. Programi i studimeve të ciklit të dytë "Master profesional" realizohet me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 1.5 vite akademike.

3. Programi i studimeve, përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, të fillojë në vitin akademik 2013-2014.

4. Efektet financiare për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i Universitetit Politeknik i Tiranës pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj